




REPUBLIKA E SHQIPERISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-
SIGURIMIT TË SHETIT**



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

Nr. 1126 Prot., Tiranë, më 19,05, 2026

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I
TIRANËS**



Nr. 1614 Prot., Tiranë, më 19,05, 2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

dhe

**AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË
SHETIT**

“Për koordinimin e punës së ndërsjellë dhe institucionalizimin e marrëdhënieve”

Sot, me datë 19/05 2026 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, (referuar më tej si “Autoriteti”/“AIDSSH”), me seli në Tiranë, me adresë në Njësinë Administrative nr. 4, rruga “Kongresi i Manastirit”, garnizoni “Skënderbej”, përfaqësuar nga Dr. Gentiana Sula, kryetari i Autoritetit,

dhe

Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) institucion publik i arsimit të lartë me adresë: Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Akli Fundo.

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “Pala” ose bashkarisht si “Palët”.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje të nënshkruar midis Autoritetit dhe Universitetit, është konkretizimi i formave zyrtare të bashkëpunimit ndërinstitucional për:

- Realizimin e kërkimeve shkencore dhe teknike për identifikimin e vendvarrimeve të dyshuara të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, duke kombinuar dokumentacionin arkivor me teknologjitë gjeofizike.
- Përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore me ndikim shkencor dhe shoqëror.
- Bashkëpunimin në fushën e teknologjisë së informacionit, përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale në analizën dhe strukturimin e dokumenteve arkivore.
- Zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe platformave “e-learning”.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 7850, datë 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për Funkzionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”; Ligjit nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 27.02.2019, “Për Përcaktimin e Tarifave dhe të Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës; Rregullores “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; Planit Strategjik 2023-2028 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Neni 3

Fusha e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

1. Kërkime të përbashkëta në terren dhe analiza laboratorike.
2. Organizim konferencash, tryezash teknike dhe publikime shkencore.
3. Praktika studentore dhe mbështetje për tema diplome.
4. Ofrim ekspertize teknike në gjeofizikë, gjeodezi, analizë të të dhënave dhe inteligjencë artificiale.
5. Shkëmbim informacioni dhe asistencë teknike ndërinstitucionale.

Neni 4

Angazhimet dhe të drejtat e palëve

1. Në përmbushje të kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti dhe Universiteti angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës për kërkimin shkencor, teknik dhe dokumentar, si dhe në shkëmbimin e asistencës teknike, sipas qëllimit për të cilin lidhet kjo Marrëveshje.

2. Autoriteti angazhohet të ofrojë:

- Mundësinë që stafi dhe studentët e Univeritetit të marrin pjesë në vrojtimet në terren dhe të kenë të drejtë të analizojnë të dhënat teknike që lidhen me vendndodhjet e personave të zhdukur;
- Kopje/dublikata të dokumenteve kundrejt tarifave të reduktuara për qëllime studimore, sipas parashikimeve ligjore;
- Vënien në dispozicion të mjediseve të veta për veprimtari të përbashkëta, për aq sa lejohet nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar.
- Angazhimin e studentëve të Universitetit në punë dhe veprimtari praktike për aplikimin e metodave joinvazive për identifikimin e vendvarrimeve të dyshuara;
- Mbështetjen teknike me stafin përkatës, për të mbështetur në punën kërkimore pedagogët dhe stafin e Univeritetit, në kuadër të përmbushjes së qëllimit të marrëveshjes.

3. Universiteti angazhohet të ofrojë:

- Vënien në dispozicion të pajisjeve dhe personelit të kualifikuar për matje gjeofizike dhe përpunim të të dhënave, sipas kontratave të shërbimit që mund të lidhen në përputhje me VKM nr. 188, datë 13.02.2019, "Për Ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të Shërbimeve, në Përputhje me Veprimtarinë e tyre, për Institucionet e Qeverisjes Qendrore dhe Institucionet në Varësi të tyre", të ndryshuar;
- Ofrimin e asistencës teknike në mikro-topografi, gjeodezi dhe gjeo-radar për evidentimin e anomalive të mundshme të lidhura me vendvarrime;
- Përfshirjen e studentëve "Master" në tema kërkimore mbi metodat gjeofizike joinvazive dhe analizën e të dhënave;
- Vënien në dispozicion të laboratorëve dhe koordinimin e stafit akademik në projekte të përbashkëta, sipas kushteve dhe mundësive;
- Realizimin e praktikave në terren mbi koordinatat e vendvarrimeve të dyshuara, për identifikim anomalish dhe analizë të imazheve ajrore;
- Dhënien e ekspertizës, sipas kushteve dhe mundësive, në fushën e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë së informacionit për përpunimin dhe administrimin e dokumenteve arkivore, sipas VKM nr. 188, datë 13.02.2019.

Neni 5

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të lidhet me një afat të pacaktuar dhe hyn në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit.
2. Marrëveshja mund të përfundohet dhe të zgjidhet nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit

të saj, dhe për pronësinë intelektuale të materialeve/produkteve të krijuara si rrjedhojë e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 7

Komunikimi midis palëve

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe për mbarëvajtjen e saj, palët merren vesh për caktimin e personave të kontaktit, të cilët do të luajnë rol koordinues për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Kordinatorët do të jenë përgjegjës për organizimin e takimeve, shkëmbimin e informacionit dhe ndjekjen e detyrave të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Ky kordinator më tej do t'i komunikohet dhe palës tjetër.
3. Koordinatorët do të mbajnë takime ndërmjet tyre (fizikisht dhe/apo virtualisht) në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacionit, si dhe do të informojnë titullarin përkatës të institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për të vlerësuar programin e bashkëpunimit dhe të planeve të shkëmbyera e të përbashkëta, në përputhje me parashikimet që përmban kjo Marrëveshje, me synim caktimin e hapave të mëtejshëm.
4. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përfshirë format më të shpejta të komunikimit elektronik.
5. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohen personat e parashikuar në pikat e mësipërme.

Neni 8

Pronësia intelektuale

1. Kjo Marrëveshje mbështetet në Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to”, si dhe Ligjin nr. 9947/2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.
2. Palët ruajnë të gjitha të drejtat mbi pronësinë intelektuale që zotërojnë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
3. Rezultatet shkencore, akademike apo teknologjike të krijuara në kuadër të projekteve të përbashkëta apo çdo krijim tjetër intelektual do të jenë pronë e përbashkët e palëve, në përpjesëtim me kontributin efektiv të secilës palë, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me marrëveshje të posaçme me shkrim.

Neni 9

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

Çdo informacion i shkëmbyer ndërmjet Palëve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, i cili nuk është publik, konsiderohet informacion konfidencial. Palët angazhohen të ruajnë

konfidencialitetin e këtij informacioni, të mos e zbulojnë atë tek palë të treta pa pëlqim paraprak me shkrim dhe ta përdorin vetëm për realizimin e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Amendimi i Marrëveshjes

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë, do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e të dyja palëve, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjë në fuqi vetëm pas nënshkrimit nga të dyja palët.
3. Kjo marrëveshje lidhet në terma të përgjithshëm dhe mundëson lidhjen e marrëveshjeve specifike midis dy institucioneve dhe njërive të tyre, për fusha dhe projekte të caktuara bashkëpunimi.

Neni 11

Dispozita të Përgjithshme

Ndryshimet ose shtesat e pjesëshme që do t'i bëhen kësaj marrëveshjeje do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.

Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PALËT

Universiteti Politeknik i Tiranës

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

REKTORI

Prof. Dr. Akli FUNDO



KRYETARI

Dr. Gentiana SULA

